

## Java III TEMA: PROCESI I REGJISTRIMIT KONTABËL

### Njësitë e procesit kontabël

LLOGARIA (KONTO) është një format standard, i cili përdoret për grumbullimin e efekteve monetare të transaksioneve për çdo element të pasqyrave financiare. Kjo konsiderohet si njësi bazike e procesit kontabël.

DITARI, si njësi tjetër bazike e procesit kontabël, përdoret për regjistrimin e transaksioneve në mënyrë kronologjike sipas datave të ndodhjes së tyre. Gjithmonë transaksionet fillimisht regjistrohen në ditar dhe pastaj barten në librin kryesor.

LIBRI KRYESOR (I MADH) është një regjistër në të cilin përfshihen të gjitha llogaritë. Të dhënat e llogarive të në librin kryesor janë të dhëna të kopjuara (bartura) drejtpërdrejtë prej ditarit.

### Sistemi i regjistrimit të dyfishtë

Regjistrimi i dyfishtë nënkupton se efektet e çdo transaksioni evidencohen së paku në dy llogari, sepse çdo ndërrim ekonomik ka efekte të dyanshme.

Shembull. Nëse një firmë blen mallra në vlerë prej 5,000 € me afat pagese, si do të regjistrohet dhe cilat llogari do të kenë efekt nga ky transaksion?

Përgjigje:

Në bazë të situatë së përshkruar pra kemi efekt në këto dy llogari (konto)

- a) Llogaria e mallrave – rritet për 5,000 €,
- b) Llogaria e pagueshme (borxhi)- rritet gjithashtu për 5,000 €.

Pra siç mundë të shihet nga ky shembull i thjeshtë është se, transaksioni i paraqitur ka efekt efekt në dy llogari (konto). Pra njëri në anën e majtë të llogarisë së mallrave për 5,000 € , si dhe tjetri në anën e djathtë të llogarisë së pagueshme tregtare për 5,000 € .

### Llogaria (Konto) "T" (e formës "T")

Llogaria e formës "T" përdoret në analizën e transaksioneve dhe përbëhet prej tri elementeve

- a) Titulli i llogarisë
- b) Ana e majtë (debiti)
- c) Ana e djathtë (kredit)

Emri i llogarisë	
(Ana e majtë)	(Ana e djathtë)
Debiti	Kredit

Tani pasi që jemi njohur me llogarinë e formës T do të provojmë efektet nga shembulli i mëparshëm t'i paraqesim në llogarinë e formës T.

Pra nga shembulli i mëparshëm se nga ky transaksion kemi impakt në dy llogari njëra në llogarinë e mallrave dhe tjetri në llogarinë e pagueshme

- a) Blerja e mallrave ka rritur (debituar) llogarinë e mallrave për 5,000 €

Mallrat	
5,000 €	

- b) Tani duhet regjistruar efektin tjetër i cili ndikon në anën tjetër (kredit) të llogarisë së pagueshme (borxh, detyrim) i cili do të duket kështu:

Llogaritë e pagueshme	
	5,000 €

Pra kemi parë se si do të dukej efekti i një ndërrimi (transaksioni) dhe cilat llogari do të efektohen me këtë rast.

## Debiti dhe Kredi

Në kontabilitet termat debi dhe kredi përdoren për të specifikuar anën e majtë dhe anën e djathtë të llogarisë. Termat Debi dhe Kredi janë terma ndërkombëtarë të kontabilitetit dhe thjesht u referohen vetëm anës së majtë dhe anës së djathtë të llogarisë "T", kurse rritja apo zvogëlimi i llogarisë në anën e debisë dhe në atë të kredisë varet nga lloji i llogarisë. Disa llogari rriten në anën e debisë kurse disa të tjera rriten në anën e kredisë, dhe në të kundërtën disa llogari zvogëlohen në anën e debisë kurse disa të tjera zvogëlohen në anën e kredisë.

Pasuria		Kapitali aksionar		Detyrimet	
Debi	Kredi	Debi	Kredi	Debi	Kredi
Rritjet	Zvogelimet	Zvogelimet	Rritjet	Zvogelimet	Rritjet

Çdo transaksion ndikon në dy ose më shumë llogari të ekuacionit bazik të kontabilitetit për të mbajtur të njëjtin në baraspeshë. Pra nga kjo rezulton se për çdo transaksion totali i debisë dhe kredisë duhet të jetë i barabartë.

### Zgjerimi i ekuacionit të bilancit

Të hyrat dhe shpenzimet janë kategori të fitimit të mbajtur dhe në ekuacion bazik të kontabilitetit ato përfshihen në totalin e kapitalit aksionar, meqenëse fitimi i mbajtur është komponentë përbërëse e kësaj kategorie. Për të hyrat dhe shpenzimet në kontabilitet gjithashtu mbahen llogari të veçanta.

Rregullat për rritjet dhe zvogëlimet e këtyre kategorive krijohen mbi bazën e logjikës kontabël si në vijim:

- a) Fitimi i mbajtur rritet në anën e kredisë
- b) Të hyrat janë rritje në fitimin e mbajtur

Kjo pra paraqet rregullën e regjistrimit të rritjeve dhe zvogëlimeve në llogarinë e të hyrave.

Ngjashëm me të hyrat edhe për shpenzimet krijohen rregullat për regjistrimin e rritjeve dhe zvogëlimeve në llogari të shpenzimeve si në vijim:

- a) Fitimi i mbajtur zvogëlohet në anën e kredisë
- b) Shpenzimet janë një zvogëlim në fitimin e mbajtur.

Nga këto dy rregulla rezulton rregulla për regjistrimin e rritjeve dhe zvogëlimeve në llogarinë e shpenzimeve. Sipas kësaj rregulle në llogarinë e shpenzimeve rritjet regjistrohen në anën e debisë, kurse zvogëlohen në anën e kredisë.

Devidendët kur deklarohen e ulin fitimin e mbajtur. Prandaj rritjet kësaj llogarie regjistrohen në anën e debisë kurse zvogëlimet në kredi.

Ekuacioni bazik i kontabilitetit në formë të zgjeruar i cili i involvon edhe të hyrat, shpenzimet dhe dividendin është në vijim

Pasuria		Kap aksionar		Fitimi mbajtur		Detyrimet		Te hyrat		Shpenzimet		Devidendi	
Dr	Cr	Dr	Cr	Dr	Cr	Dr	Cr	Dr	Cr	Dr	Cr	Dr	Cr
+	-	-	+	-	+	-	+	-	+	+	-	+	-

Ushtrim:

Në tabelën e paraqitur së bashku duke bashkëbiseduar dhe komentuar, të plotësohen fushat e zbrazëta duke shënuar për secilën llogari se në cilën anë rritet dhe në cilën anë zvogëlohet ajo llogari.

Llojet e llogarive	Në Debi	Në Kredi
Pasuria		
Kapitali Aksionar		
Detyrimet		
Te hyrat		
Shpenzimet		
Devidenda		

**Saldot (gjendjet) normale të llogarisë**

Diferenca ndërmjet totalit të debisë dhe kredisë emërtohet saldo (gjendje, tepricë, balancë) e llogarisë. Pra çdo llogari e pasqyrave financiare në fund të periudhës kontabël ka një saldo debitore ose kreditore.

Në qoftë se shuma e totalit të debisë e tejkalon totalin e kredisë atëherë llogaria ka saldo (gjendje) debitore dhe në qoftë se totali i kredisë tejkalon totalin e debisë atëherë llogaria ka saldo kreditore.

Shembull: llogaria e kesh-it gjatë periudhës ka pasur këto transaksione:

Debi	Keshi (paraja)	Kredi
	25,000	5,000
	10,000	15,000
	30,000	25,000
	5,000	
Saldo	25,000	

në fund të periudhës në llogarinë e keshit diferenca ndërmjet totalit të debisë prej 70,000 € si dhe totalit të kredisë prej 45,000 € është vlera prej 25,000 € e cila njëherësh paraqet edhe saldon (gjendjen) debitore të llogarisë së keshit.

Llogaritë e pasurisë saldon e tyre normale e kanë debitore. Pra duke u bazuar në rregullat e debisë dhe të kredisë rrjedh se të gjitha llogaritë e pasurisë rriten në anën e kredisë, kurse zvogëlohen në anën e debisë:

	Debi	Pasuria	Kredi
↑	Regjistrohen rritjet		Regjistrohen zvogelimet
	Saldo normale debitore		

↓

Llogaritë e Kapitalit Aksionar dhe të detyrimeve saldon (gjendjen) e tyre normale e kanë kreditore. Pra, rritjet e këtyre llogarive regjistrohen në anën e kredisë kurse zvogëlimet në anën e debisë. Shumat monetare të regjistruara në anën e kredisë së këtyre llogarive tejkalojnë gjithmonë shumën monetare të evidentuar në anën e kredisë, prandaj llogaritë e tilla gjendjen e tyre normale e kanë kreditore:

	Debi	Kapitali Aksionar	Kredi
↓	Regjistrohen zvogelimet		Regjistrohen rritjet
			Saldo normale kreditore

↑

	Debi	Detyrimet	Kredi
↓	Regjistrohen zvogelimet		Regjistrohen rritjet
			Saldo normale kreditore

↑

Fitimi i mbajtur paraqet netofitimin e fitimin i cili nuk është shpërndarë, qoftë për dividend ose për t'u reinvestuar në firmë. Saldo normale e llogarisë së fitimit është saldo kreditore:

	Debi	Fitimi i mbajtur	Kredi
↓	Regjistrohen zvogelimet		Regjistrohen rritjet
			Saldo normale kreditore

↑

Devidendët përfaqësojnë shpërndarjen e keshit ose të ndonjë pasurie tjetër nga ana e kompanisë për aksionarët e vet. Rritjet e dividendit regjistrohen në debi të kësaj llogarie, kurse zvogëlimet në anën e kredisë.

	Debi	Devidendi	Kredi
	Regjistrohen rritjet		Regjistrohen zvogelimet
	Saldo normale debitore		

Të hyrat janë kategori e fitimit të mbajtur. Kur të hyrat njihen në kontabilitet, rritjet e tyre regjistrohen në kredi, kurse zvogëlimet e tyre në anën e debisë së llogarisë së të hyrave. Saldo normale e llogarisë së të hyrave është kreditore:

	Debi	Të hyrat	Kredi
	Regjistrohen zvogelimet		Regjistrohen rritjet
			Saldo normale kreditore

Shpenzimet e zvogëlojnë fitimin e mbajtur. Rritjet e këtyre llogarive regjistrohen në debi, kurse zvogëlimet në kredi. Saldoja normale e llogarisë së shpenzimeve është debitore:

	Debi	Shpenzimet	Kredi
	Regjistrohen rritjet		Regjistrohen zvogelimet
	Saldo normale debitore		

Ushtrim: Në tabelën në vazhdim të plotësohen katrorët e zbrazët me përgjigjen adekuate për saldon normale për llogaritë e shënuara:

Lloji i llogarisë	Saldot (gjendjet) normale
Pasuria	Debitore
Kap aksionar	Kreditore
Detyrimet	
Fitimi i mbajtur	
Të hyrat	
Shpenzimet	
Devidendët	

### Analiza dhe evidenca e transaksioneve në llogaritë e librit kryesor

Shembull: përdorimi i termave të debisë dhe kredisë për regjistrimin e transaksioneve dhe interpretimi i analizës së transaksioneve dhe prezantimi i regjistrimit të tyre në llogarinë "T"

- 1) Më 1 mars 2007 Ermal Brovina ka filluar punën në një firmë të regjistruar si agjenci turistike "Brovina Tours". Në këtë datë ai ka hapur llogari bankare për firmën e tij dhe fillimisht ka deponuar 70,000 € kesh.
  - a) Analiza: Është rritur llogaria e pasurisë- Keshi. Gjithashtu është rritur një llogari tjetër – Kapitali i pronarit Brovina.
  - b) Rritjet e pasurisë regjistrohen në anën e debisë kurse rritjet e kapitalit regjistrohen në kredi.
  - c) Regjistrimi i transaksionit:

Debi	Pasuria	Kredi

Debi	Kapitali Brovina Turs	Kredi

- 2) Më 2 mars "Brovina Tours" ka blerë një lokal për zyre në vlerë prej 30,000 me afat pagese (kredit) 2 muaj
  - a) Është rritur një llogari e pasurisë ndërtesat dhe në anën tjetër është rritur një llogari e detyrimeve – furnitorët (llogari e pagueshme)
  - b) Rritjet e pasurisë – debi; rritjet e detyrimeve – kredi
  - c) Regjistrimi i transaksionit:

Debi	Ndertesat	Kredi

Debi	furnitoret	Kredi

- 3) Më 3 mars "Brovina Tours" ka blerë mobilie dhe pajisje të tjera për zyrë në vlerë prej 15,000 € kesh
- a) Analizë: Është rritur llogaria e pasurisë-pajisjet. Njëkohësisht është zvogëluar një llogari e pasurisë-keshi.
- b) Rritjet e pasurisë- Debi; zvogëlimet e pasurisë-Kredi
- c) Regjistrimi i transaksionit

Debi	Pajisjet	Kredi

- 4) Më 4 mars "Brovina Tours" ka shitur bileta dhe shërbime të tjera për 6,000 €. Nga këto shërbime të shitura për 1,000 € është pranuar kesh, kurse të tjerat janë shitur me afat pagese (kredi) për një muaj.
- a) Analiza: Është rritur llogaria e pasurisë-keshi, dhe është rritur llogaria e arketueshme –Blerësit për shumën e arkëtueshme të shitjeve. Gjithashtu është rritur një nënkategori e kapitalit- Llogaria e të hyrave
- b) Rritjet e pasurisë-debi; Rritjet e llogarisë së të hyrave-Kredi
- c) Regjistrimi i transaksionit

Debi	Blerësit(LI/Ar)	Kredi

Debi	Te hyrat	Kredi



- 5) Më 5 mars firma ka blerë në kesh 1,200 €, një aparat të fotokopjes.
- a) Analiza: Është rritur një llogari e pasurisë-Pajisjet. Është zvogëluar një llogari e pasurisë-Keshi
  - b) Rritjet e pasurisë-Debi; zvogëlimet e pasurisë-Kredi
  - c) Regjistrimi i transaksionit

- 6) Më 27 Mars firma ka përmbushur me kesh detyrimin ndaj furnitorit lidhur me mobilet e blera më parë në vlerë 15,000 €
- a) Analiza: Është zvogëluar llogaria e pasurisë-keshi, njëkohësisht është zvogëluar llogaria e detyrimeve (furnitorët)
  - b) Zvogëlimet e pasurisë-Kredi; zvogëlimi i detyrimeve-Kredi
  - c) Regjistrimi i transaksionit

- 7) Më 29 Mars "Brovina Tours" ka paguar në kesh këto shpenzime operative:

300 € për shpenzime të rrymës,  
1,200 € shpenzime për paga, dhe  
100 € në emër të shpenzimeve të ujit

- a) Analiza: Është zvogëluar një llogari e pasurisë-keshi. Janë rritur tri llogari të shpenzimeve: shpenzimet e rrymës, shpenzimet e pagave, dhe shpenzimet e ujit. Shpenzimet e rrymës dhe ujit ndryshe emërtohen edhe si shpenzime të shërbimeve publike.
- b) Zvogëlimet e pasurisë regjistrohen në anën e Kredisë; Rritjet e llogarive të shpenzimeve bëhen në anën e Kredisë.
- c) Regjistrimi i transaksionit:


D Shpenzimet e shërbimeve publike K

D Shpenzimet e pagave K

- 8) Më 27 Mars firma ka përmbushur me kesh detyrimin ndaj furnitorit lidhur me ndërtesën e blerë më parë në vlerë prej 14,000 €
- a) Analizë: Është zvogëluar llogaria e pasurisë-keshi. Njëkohësisht është zvogëluar llogaria e detyrimeve-furnitori
  - b) Zvogëlimet e pasurisë evidentohen në anën e kredisë; kurse zvogëlimet e detyrimeve në anën e debisë.
  - c) Regjistrimi i transaksionit

- 9) Më 31 mars pronari i "Brovina Tours" ka tërhequr prej firmës për nevoja personale 200 € kesh:
- a) Analiza: Është rritur një llogari e pasurisë-llogaria Tërheqjet e pronarit "Brovina Tours". Është zvogëluar një llogari e pasurisë-keshi. Llogaria tërheqjet e pronarit është llogari e përkohshme dhe llogari e kundërt e kapitalit të pronarit.
  - b) Rritjet e pasurisë-Debi; kurse zvogëlimet e pasurisë-Kredi.
  - c) Regjistrimi i transaksioneve:

D Terheqjet e pronarit "Brovina Turs "K



### Regjistrimi i transaksioneve në Ditar

Procesi i regjistrimit të transaksioneve në ditar quhet Ditarizim. Transaksionet fillimisht regjistrohen në ditar e pastaj barten në llogarinë e librit kryesor kurse ky proces quhet bartje (postim)

Ditari

Data	Emri i llogarisë dhe përshkrimi	Ref	Debi	Kredi